



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:150693
Datë: 27.02.2024
Numri i dokumentit: 05380681

KPPP.nr.1039/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit BABY FOOD BIO Sh.P.K., me adresë në rrugën Pajazit Islami në Fushë Kosovë, me NUI: 810151853, kundër debitorit V.G.D. B.I., me adresë në Fushë Kosovë, 17 Shkurti, me NUI: 810962028, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.227/2023 të datës 08.06.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 06.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit V.G.D. B.I., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.227/2023 të datës 08.06.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, me Urdhrin Përmbartimor P.nr.227/2023 të datës 08.06.2023, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturës nr.1-30 të datës 26.05.2023, me të cilin ka urdhëruar që menjëherë nga dita e pranimin të këtij urdhri, t'ia paguajë kreditorit shumën prej 1,493.90 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përmbauesit Privat, ka ushtruar prapësim debitori, për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore të LPP-së dhe vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike. Tutje ka theksuar se sipas dispozitave të nenit 37 dhe 40 të LPP-së, përmbarimi në bazë të dokumentit të besueshëm bëhet në rast kur propozimit i bashkëngjitet dokumenti origjinal apo kopja e vërtetuar sipas ligjit, dhe i cili duhet të jetë në harmoni me pretendimet e paraqitura në urdhër, ndërsa fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i është bashkëngjitur propozimit ashtu siç kërkohet me ligj dhe e njëjta nuk e arrin vlerën e pretenduar. Ka shtuar se urdhri i lëshuar nuk i plotëson kushtet, ndërsa në propozimin për përmbarim ka mangësi në prezantim të fakteve dhe nuk arsyetohet gjendja reale e raportit të biznesit në mes të kreditorit dhe debitorit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përmbarimor i Përmbauesit Privat, si dhe të obligohet kreditori që debitorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe atë për përpilimin e prapësimit dhe shpenzimeve tjera eventuale në këtë procedurë.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se debitori ka ushtruar prapësim pa kurrfarë baze ligjore e as morale, por ide mashtruese, për shkak të vonesës në kryerjen e obligimeve të cilat i ka. Tutje ka shtuar se në marrëveshje me Përmbauesin Privat kemi rënë dakord që pagesa të bëhet me dy këste, por fatkeqësisht edhe pse i plotësohet kërkesa për pagesë me këste, debitori nuk e bën pagesën, por fillon me avazin e vjetër të jo sinqeritetit dhe mashtrimit. Kreditori ka theksuar se për shkak të mos kryerjes së obligimeve sipas marrëveshjes nga ana e barnatores V.G.D. B.I., me pronare V.G.D., kërkojmë kompensimin e dëmit, ngase në mungesë të mjeteve kemi ngecur në efektivitetin e kompanisë në çdo aspekt komercial.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, pretendimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për*

përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarrim dokumentin e besueshëm faturën nr.1-30 të datës 26.05.2023, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtjesore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nr.1-30 e datës 26.05.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarrimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, e njëjta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin e debitorit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarrimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1039/23, me datë 06.02.2024

G j y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomen e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.